

# OUCH!

## NË KËTË EDICION..

- Vetëmbrojtja
- Mbrojtja e kompjuterit/llogarisë suaj
- Për prindërit

## Mënyra e sigurt e lozjes Online

### Përmbledhje

Lojërat Online janë mënyrë e mirë për t'u zbavitur, por gjithashtu përcillet edhe nga një numër rreziqesh. Në këtë broshurë ne do të mbulojmë informata se si të mbronni veten dhe familjen tuaj kur luani lojëra online.

### Vetëmbrojtja

Ajo që i bën lojërat online aq tërheqëse është fakti se mund të luani dhe të komunikoni me lojtarë tjerë kudo në botë.

Shpeshherë ju mund të mos i njihni fare njerëzit me të cilët luani. Edhe pse shumica e njerëzve që janë online duan të zbaviten sikurse ju, ka edhe të atillë që mund të kenë qëllime të këqija. Më poshtë gjeni disa hapa që mund të ndiqni që të rrini të sigurt.

- Kujdes nga mesazhe që ju kërkojnë të ndërmerri ndonjë veprim, si p.sh. të hapni ndonjë link ose të shkarkoni ndonjë fajl. Njësoj si sulmet 'phishing', njerëzit dashakëqinj do të provojnë t'ju mashtrojnë që të ndërmerri veprime që mund të infektojnë kompjuterin tuaj. Nëse mesazhi ju duket i çuditshëm, urgjent, apo shumë tërheqës për të qenë i vërtetë, atëherë jini dyshues se mund të jetë një sulm.
- Shumica e lojërave online kanë tregjet e tyre financiar ku ju mund të bleni gjëra virtuale. Sikurse ne botën reale, ka edhe mashtrues edhe në sistemet online që mund të kenë qëllime t'ju marrin të hollat tuaja.
- Kini kujdes nga blerja ku të holla të vërteta përdoren për blerje të gjërave brenda lojës. Bëni blerje vetëm në tregje që njihen dhe që kanë reputacion të mirë.
- Kufizoni sasinë e informatave që ju apo fëmijët tuaj shpërndani online. Kurrë mos ndani informata të detajuara personale si p.sh. fjalëkalimet apo adresën e shtëpisë.
- Shumë faqe interneti, si bankingu online, përdorin pyetje për siguri që konfirmojnë identitetin tuaj. Sulmuesit kanë arritur t'i marrin këto informata të fshehta duke i bërë shokë viktimat gjatë lojërave online. Mos harroni që askush nuk duhet të ju detyrojë t'i përgjigjeni pyetjeve të ndryshme gjatë lojërave online.

### Mbrojtja e kompjuterit / llogarisë suaj


Hapi tjetër për t'u mbrojtur është të siguroni kompjuterin tuaj. Njerëzit qëllimkëqinj gjithnjë provojnë të marrin kontrollin e kompjuterit tuaj apo llogarisë suaj online, andaj duhet t'i mbronni.

### Botuesi i ftuar

Jake Williams është themelues dhe konsulent kryesor në Rendition Infosec, është instruktor i certifikuar i SANS, si dhe bashkëautor i disa kurseve të SANS. Ai është aktiv në Twitter si [@MalwareJake](#) dhe në blogun [malwarejake.blogspot.com](http://malwarejake.blogspot.com).

## Mënyra e sigurt e lozjes Online

- Përdorni password (fjalëkalim) të fortë edhe për kompjuterin dhe llogarinë tuaj të lojërave online. Në këtë mënyrë sulmuesit nuk do të mund të qëllonin fjalëkalimet tuaja të kompjuterit apo llogarive tuaja. Nëse loja online ju ofron verifikimin në dy hapa, përdoreni. Poashtu, sigurohuni që llogaritë tuaja kanë fjalëkalime të ndryshme. Kështu, nëse njëri nga fjalëkalimet të thyhet atëherë llogarinë tjetër e keni të sigurt.
- Mbrojeni kompjuterin tuaj duke operuar me versionin më të ri të sistemit operativ dhe softuerit për lojëra. Njësoj si sistemi juaj operativ dhe shfletuesit e internetit, softuerët e vjetër për lojëra online mund të kenë probleme që mund të shfrytzojnë nga sulmuesit për të marrë kontrollin e kompjuterit tuaj. Duke e mbajtur të përditësuar kompjuterin dhe aplikacionet për lojëra, ju eliminoni shumicën e problemeve të njohura.
- Aktivizoni një anti-virus, sigurohuni që është i përditësuar dhe duke monitoruar fajlat tuaj.
- Shkarkoni softuerët e lojërave vetëm nga faqe të besueshme. Nëse jeni duke instaluar softuerë për lojë online, sigurohuni që e shkarkoni nga një faqe e njohur dhe e besueshme. Shumë shpesh sulmuesit kibernetikë do të krijojnë një version fals ose të infektuar të një loje, dhe e shpërndajnë atë nga serveri i tyre. Nëse e instaloni një nga këto, sulmuesit mund të marrin kontrollin e plotë të kompjuterit tuaj.
- Ekzistojnë paketa shtesë të ndryshme për lojëra, që zhvillohen zakonisht nga komuniteti i zhvilluesve, dhe që kanë për qëllim shtimin e funksioneve të reja. Sulmuesit nganjëherë i infektajnë pikërisht këto paketa me softuerë të dëmshëm që mund të jenë shumë vështirë të dallueshëm nga antivirusi. Njësoj sikurse kur shkarkoni lojëra, sigurohuni që i shkarkoni edhe këto shtesa të lojërave nga vende të besueshme. Gjithashtu, nëse ndonjë paketë e këtillë kërkon të çaktivizoni antivirusin ose të bëjë ndryshime në firewall-in tuaj, atëherë mos e përdorni.
- Tregjet e zeza kanë lulëzuar së fundi duke përkrahur aktivitete mashtruese. Përveç se janë joetike, shumë programe mashtruese janë të ashtuquajtur 'rootkit', gati softuerët më të dëmshëm. Kurrë mos instaloni asnjë lloj të softuerëve mashtrues.
- Kontrolloni faqen e internetit të lojës online që përdorni. Shumë faqe të lojërave online kanë edhe një seksion që përshkruan si të vetëmbroheni dhe si të mbronin sistemin tuaj, sigurohuni të ndiqni këshillat e tyre.
- Në fund, gjithmonë duhet të jeni të kujdesshëm kur luani lojëra online në pajisjet tuaja mobile, njësoj si në kompjuter. Kriminelët kibernetikë po i sulmojnë edhe pajisjet mobile.



*Çelësi për të qenë të sigurt online gjatë lojërave të ndryshme është të përdorni password të fortë, të siguroni kompjuterin tuaj, dhe të përdorni mendjen e shëndoshë kur pranoni mesazhe apo kërkesa të çuditshme online.*

## Mënyra e sigurt e lozjes Online

### Për prindërit

Nëse jeni prind, sigurohuni që fëmijët tuaj i ndjekin hapat e përshkruar më lart (për fëmijët e vegjël ndoshta ju duhet t'i bëni këta hapa në vend të tyre). Gjithashtu, komunikoni me fëmijët tuaj për rreziqet. Edukimi dhe komunikimi i hapur me fëmijët tuaj është një nga hapat më efektivë për t'i mbrojtur ata. Një nga mënyrat që t'i bëni fëmijët tuaj të flasin është t'i kërkoni atyre t'ju tregojnë se si funksionon loja online, duke i kërkuar atyre t'ju përshkruajnë lojën dhe hapat që ndjekin. Ndoshta edhe të luani një lojë bashkë me ta. Poashtu, kërkoni fëmijëve t'ju përshkruajnë njerëzit me të cilët komunikojnë ata online. Shumë shpesh lojërat online mund të jenë pjesë e rëndësishme e jetës shoqërore të fëmijës suaj. Duke folur me ta (dhe duke i bërë ata të flasin me ju) ju mund të dalloni ndonjë problem të mundshëm dhe t'i mbronni ata më mirë se do t'i mbronte teknologjia.

### Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen <http://www.securingthehuman.org>.

### Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyesë profesionale e gjuhës angleze në OSBE.

### Burimet

Inxhinjaria Sociale:	<a href="http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#november2014">http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#november2014</a>
Sulmet Phishing:	<a href="http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#february2013">http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#february2013</a>
Fjalëkalimet (Passwords):	<a href="http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#october2013">http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#october2013</a>
Ç'është një Anti-Virus?:	<a href="http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#december2014">http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#december2014</a>
Rrini të sigurt Online:	<a href="http://www.staysafeonline.org/stay-safe-online/for-parents/gaming-tips">http://www.staysafeonline.org/stay-safe-online/for-parents/gaming-tips</a>

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 4.0](http://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në [ouch@securingthehuman.org](mailto:ouch@securingthehuman.org).

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis  
Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano



[securingthehuman.org/blog](http://securingthehuman.org/blog)



[/secrethehuman](https://www.facebook.com/secrethehuman)



[@secrethehuman](https://twitter.com/secrethehuman)



[securingthehuman.org/gpl](https://www.securingthehuman.org/gpl)